

EDUKIMI I BREZIT TË RI PËR BUJQËSINË E QËNDRUESHME DHE SIGURINË USHQIMORE

Program trajnimi për nxënës të shkollave të mesme



Me mbështetjen e:



Pse është i rëndësishëm edukimi mbi bujqësinë e qëndrueshme dhe sigurinë ushqimore?

- Ndryshimet klimatike, shpopullimi rural dhe presioni mbi burimet natyrore po ndikojnë ndjeshëm sistemet tona ushqimore.
- Konsumatorët e rinj përballen me tregje të ndërlikuara dhe mungesë transparence në origjinën dhe cilësinë e produkteve.
- Njohuritë e hershme ndihmojnë në formimin e zakoneve të shëndetshme dhe zgjedhjeve të qëndrueshme.
- Edukimi i brezit të ri është një nga mjetet më të forta për të ndërtuar një sistem ushqimor të sigurt, të drejtë dhe të qëndrueshëm.

Bujqësia e qëndrueshme – koncepti dhe rëndësia

Bujqësia e qëndrueshme nënkupton:

- Përdorimin racional të tokës dhe ujit
- Ulje të pesticideve dhe mbrojtje të biodiversitetit
- Zhvillim të prodhimit lokal dhe zinxhirëve të shkurtër të furnizimit
- Ruajtje të tokave bujqësore dhe ekosistemeve
- Kontribut në ekonominë lokale dhe mbështetje për fermerët

Përfitimet për të rinjtë:

- Siguri më e lartë ushqimore
- Produkte më të shëndetshme
- Mundësi punësimi dhe sipërmarrjeje në sektorin agroushqimor

Siguria ushqimore – thelbi i mbrojtjes së konsumatorit

Siguria ushqimore përfshin:

- Kontrollin e cilësisë dhe pastërtisë së ushqimeve
- Parandalimin e kontaminimit biologjik, kimik dhe fizik
- Trajtimin dhe ruajtjen e saktë të produkteve
- Sistemet e gjurmueshmërisë nga ferma në tryezë
- Ndjekjen e standardeve të BE-së (HACCP, RASFF, etiketime të detyrueshme)

Edukimi për të zgjedhur ushqime të sigurta dhe të shëndetshme

► Të rinjtë trajnohen të:

- Analizojnë etiketa ushqimore (përbërësit, vlerat ushqyese, afati, origjina)
- Identifikojnë produkte jo të sigurta ose me mungesë transparence
- Njohin mashtrimet ushqimore (food fraud)
- Kuptojnë rreziqet e ushqimeve ultra të përpunuara
- Bëjnë zgjedhje të balancuara ushqimore në jetën e përditshme

► **Shembuj praktikë në trajnim:**

- Krahasim i dy produkteve të njëjta me etiketa të ndryshme
- Analiza e një menuje të kafenesë/shkollës për të identifikuar zgjidhjet më të shëndetshme

Konsumatori i zgjuar – roli i të rinjve në treg

► Konsumatori i informuar:

- Lexon etiketa dhe kërkon prova cilësie
- Reagon ndaj produkteve të dyshimta
- Kërkon standarde më të larta nga bizneset ushqimore
- Raporton rastet e pasigurisë ushqimore
- Ndjek alertet zyrtare dhe këshillat e AKU
- Zgjedh produkte të shëndetshme, lokale dhe të garantuara

► Të rinjtë janë një fuqi e madhe shoqërore: presioni i tyre pozitiv shtyn tregun drejt cilësisë.

Rrjeti i paralajmërimit të hershëm (Food Alert Network)

► **Një koncept i thjeshtë që u prezantohet nxënësve:**

- Bazuar në sistemin europian RASFF
- Informon për produkte të rrezikshme që hiqen nga tregu
- Ndhmon konsumatorët të qëndrojnë të sigurt
- Përfshin AKU, laboratorë, shkolla, OJQ dhe platforma informimi
- Nxënësit mësojnë si të ndjekin alertet dhe si t'i interpretojnë

Lidhja mes ushqimit të sigurt dhe shëndetit të nxënësve

► Pjesa praktike e trajnimit fokusohet në:

- Zgjedhje ushqimore gjatë ditës së shkollës
- Identifikimin e ushqimeve që rrisin energjinë dhe koncentrimin
- Rrezikun e pijeve energjike, fast-food dhe sheqernave të fshehura
- Planifikimin e vakteve të balancuara
- Ndërtimin e një marrëdhënieje të shëndetshme me ushqimin

Çështjet që duhen njohur në tregun ushqimor shqiptar

- Etiketim jo i plotë / i pasaktë
 - Produkte të sjella nga importi me standarde të paverifikuara
 - Ndikimi i tregjeve informale
 - Sfidat e prodhuesve vendas për të përmbushur standardet e BE
 - Dëmtimet që sjell mungesa e kontrollit të ftohjes dhe ruajtjes
- ▶ Të rinjtë mësojnë se si t'i shmangin këto rreziqe.

Shembull praktik: kontrolli i cilësisë së një produkti ushqimor

- ▶ Në trajnim përfshihen ushtrime të drejtpërdrejta:
 - Verifikimi i origjinës
 - Kontrolli i etiketes
 - Analiza e pamjes së jashtme
 - Vlerësimi i çmimit (shumë i ulët = rrezik)
 - Data e skadencës dhe kushtet e ruajtjes
- ▶ Krahasime mes produkteve të ndryshme

Roli i të rinjve në transformimin e sistemit ushqimor

► Të rinjtë mund të bëhen:

- “Ambasadorë” të ushqimit të sigurt në shkollë
- Promotorë të stilit të shëndetshëm të jetesës
- Raportues aktivë të rreziqeve ushqimore
- Mbështetës të produkteve të qëndrueshme dhe lokale
- Pjesë e iniciativave komunitare për bujqësi dhe mjedis

Ndikimi i edukimit mbi integrimin europian

► Ky program kontribuon në:

- Afërsimin me acquis të BE në sigurinë ushqimore
- Ndërtimin e kulturës së cilësisë dhe gjurmueshmërisë
- Rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare
- Modernizimin e sektorit agroushqimor
- Ndërgjegjësimin e konsumatorit si faktor transformues
- Afrimin e Shqipërisë me vlerat dhe praktikatat europiane

Përfundim

► **Edukimi i nxënësve krijon:**

- një brez të ri të ndërgjegjshëm,
- një konsumator të informuar,
- një treg më të sigurt,
- dhe një bujqësi më të qëndrueshme.